

Perceptimet dhe
Qëndrimet Publike
ndaj

Barazisë Gjimore në Shqipëri



STUDIM PILOT

Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri

Janar 2016 - Tiranë, Shqipëri

Ky raport studimor u hartua me porosi të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Suedisë.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) apo të Kombeve të Bashkuara.

Tiranë, Janar 2016

Përgatitur nga: Dr. Marsela Dauti dhe Dr. Edvin Zhllima

Përkthyes dhe redaktore në gjuhën shqipe: Majlinda Nishku



PËRMBLEDHJE

Ky studim hulumton perceptimet publike mbi barazinë gjinore në Shqipëri. Ai mbështetet në 450 intervista të zhvilluara në katër rajone të vendit – një malor, një bregdetar, një qendror, dhe rajoni i Tiranës – dhe hedh dritë mbi aspektet e mëposhtme: ndarja e punëve të shtëpisë, ndarja e përgjegjësisë të kujdesit për fëmijët, perceptimet dhe qëndrimet ndaj roleve të grave dhe burrave në familje, punësimi dhe të ardhurat, menaxhimi i parave, balanca karrierë-familje, si dhe rekomandimet për fushat e ndërhyrjes për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës dhe ndihmesën e burrave dhe djemve në familje. Më poshtë vijon një përmbledhje e gjetjeve kryesore të studimit:

- Pjesa më e madhe e personave të intervistuar – më se 80 për qind e tyre – raportuan se janë zakonisht gratë ato që bëjnë larjen dhe hekurosjen e rrobave, pastrimin e shtëpisë, gatimin dhe larjen e enëve. Dy punët e shtëpisë në të cilat burrat kishin gjasa të angazhoheshin më shumë se gratë lidheshin me riparimet në shtëpi dhe pagimin e faturave. Gratë dhe burrat zakonisht ndanin

më shumë detyrat e mëposhtme me njëri-tjetrin: hedhjen e plehrave, bërjen e pazareve, dhe përkujdesin për anëtarët e sëmurë të familjes.

- Gratë dhe burrat kishin perceptime të ndryshme për ndihmesat që japin në familje. Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin se punët e shtëpisë ndaheshin në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre dhe grave. Për shembull, burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin se pastrimi i shtëpisë ishte një përgjegjësi që ndahej në mënyrë të barabartë me gratë. Po kështu, burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin se larja e enëve ishte një përgjegjësi që ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave.
- Rreth 50 për qind e personave të intervistuar raportuan se kujdeseshin për fëmijët e tyre së bashku me bashkëshortin/partnerin. Megjithatë, këtu u vu re një ndarje e theksuar gjinore. Burrat kishin më shumë

gjasa se gratë të thoshin se kujdeseshin për fëmijët së bashku me bashkëshorten/partneren e tyre: 60,47 për qind kundrejt 41,89 për qind. Ndërkohë, gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportnin se ishin ato që kujdeseshin për fëmijët dhe se nuk kishin ndonjë mbështetje apo ndihmë nga bashkëshortët. Gratë dhe burrat kishin më shumë gjasa të ndanin përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët në raste të emergjencave shëndetësore.

- Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportnin që "kujdesi për fëmijët" ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Përqindja e burrave që raportuan se "kujdesi për fëmijët" ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave ishte përafërsisht dy herë më e lartë se përqindja e grave, përkatësisht 27,91 për qind dhe 13,51 për qind.
- Perceptimet publike ndryshonin edhe në varësi të nivelit arsimor. Të intervistuarit me nivel më të lartë arsimor kishin më pak gjasa të raportnin për një ndarje tradicionale gjinore të punëve në familje. Për shembull, të intervistuarit me nivel më të lartë arsimor – arsim universitar e lart – kishin më shumë gjasa të raportnin se hedhja e mbeturinave ishte një përgjegjësi që ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Ishte më e madhe përqindja e personave të intervistuar me nivel më të lartë arsimor që thanë se "vënia e fëmijës në gjumë" ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Po kështu, të intervistuarit me nivel më të lartë arsimor kishin më shumë gjasa

të mos ishin dakord, ose të mos ishin aspak dakord, me pohimin "është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen."

- Edhe lloji i rajonit (malor, bregdetar, qendror dhe ai i Tiranës), si dhe i zonës (urbane kundrejt rurale), kishte lidhje me perceptimet. Të intervistuarit në rajone me nivel të ulët të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror kishin më shumë gjasa të ishin dakord me rolet gjinore tradicionale. Për shembull, krahasuar me të intervistuarit në zonat rurale, kishte një përqindje më të madhe të të intervistuarve në zonat urbane që raportuan se larja e enëve ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Të intervistuarit në zonat rurale kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin "një bashkëshorte e mirë duhet t'i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje."
- Numri mesatar i orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë në ditë ishte 3,35 ($DS = 2,69$; *intervali*: 0 – 20). Arsimi, gjinia, dhe të ardhurat në nivel personal kishin ndikim në numrin e orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë. Të intervistuarit me arsim universitar e lart raportuan se shpenzonin më pak orë me punët e shtëpisë ($M = 2,73$, $DS = 2,24$) se sa të intervistuarit me arsim të mesëm ose më të ulët ($M = 3,51$, $DS = 2,78$). Gratë raportuan se shpenzonin më shumë kohë me punët e shtëpisë ($M = 4,66$, $DS = 2,71$) se sa burrat ($M = 2,07$, $DS = 1,97$). Burrat raportuan se bashkëshortja/partnerja e tyre shpenzonte më shumë kohë duke

bërë punët e shtëpisë ($M = 5,69$, $DS = 3,03$), në krahasim me sasinë e kohës të raportuar nga gratë ($M = 1,35$, $DS = 1,86$). Marrëdhënia ndërmjet të ardhurave individuale dhe numrit të orëve të shpenzuara me punët e shtëpisë ishte e zhdrejtë. Me fjalë të tjera, me rritjen e të ardhurave individuale, numri i orëve të shpenzuara me punët e shtëpisë pakësohej.

- Gratë kishin më pak gjasa të ishin të kënaqura me ndarjen e detyrave në familje ($M = 3,80$, $DS = 1,20$) se sa burrat ($M = 4,19$, $DS = 1,11$). Sa më i madh numri i fëmijëve nën moshën 11 vjeç, aq më i ulët ishte niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë. Nuk kishte dallime në nivelin e të qenit i/e kënaqur sipas llojit të rajonit (urban kundrejt rural), gjendjes civile (i/e martuar kundrejt i/e pamartuar), arsimit ('universitar e lart' kundrejt 'tjetër'), dhe nivelit arsimor të partnerit ('universitar e lart' kundrejt 'tjetër').
- Gratë kishin më pak gjasa të ishin të kënaqura me ndarjen e përgjegjësiive të kujdesit për fëmijët ($M = 3,79$, $DS = 1,21$) se sa burrat ($M = 4,44$, $DS = 1,03$).
- Të intervistuarit kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin "një bashkëshorte e mirë duhet t'i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje," ndjekur nga pohimi "është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen." Ndërkohë, të intervistuarit kishin më pak gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin "burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë

në punët e shtëpisë," i ndjekur nga pohimi "burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve."

- Perceptimet publike ndryshojnë sipas gjinisë. Krahasuar me gratë, burrat kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin "një bashkëshorte e mirë duhet t'i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje," me 78,95 për qind, kundrejt 71,17 për qind. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të mos ishin dakord ose të mos ishin aspak dakord me pohimin "gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen."
- Të intervistuarit me përvojë migrimi, krahasuar me ata që nuk kishin ndonjë përvojë të tillë, kishin më shumë gjasa të raportonin që disa nga punët e shtëpisë, si bërja e pazareve, gatimi, dhe hedhja e mbeturinave, ndaheshin në mënyrë pothuaj të barabartë ndërmjet grave dhe burrave.
- 40,89 për qind e personave të intervistuar ($n = 184$) raportuan se, si burrat ashtu edhe gratë, kishin mundësi të barabarta në tregun e punës; 35,33 për qind e personave të intervistuar ($n = 159$) thanë se burrat kishin mundësi më të mëdha; dhe 23,78 për qind ($n = 107$) thanë se gratë kishin mundësi më të mëdha. Nuk kishte dallime statistike domethënëse sipas gjinisë së personit të intervistuar.
- Më pak se 50 për qind e personave të

intervistuar thanë se nuk kishte rëndësi se cilës gjini i përkiste drejtuesi në vendin e punës, femër apo mashkull. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të parapëlqenin të kishin një grua për drejtuese. 32,43 për qind e grave (n = 72) thanë se parapëlqenin të kishin një grua për drejtuese, ndërsa vetëm 22,37 për qind e burrave (n = 51) thanë se parapëlqenin të kishin një grua drejtuese.

- Hendeku gjinor ndërmjet grave dhe burrave është më i madh tek personat me nivele më të ulëta arsimore. Dallimi në të ardhura ndërmjet grave dhe burrave me arsim të mesëm ose më të ulët ishte 194 053,7 lekë në muaj. Kurse hendeku gjinor ndërmjet grave dhe burrave me arsim universitar e lart ishte 48 773,91 lekë në muaj.
- Ndërhyrjet që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës duhet të përqendrohen në: shtimin e

mundësive për trajnim dhe kualifikime; ofrimin e mundësive të kujdesit për fëmijët në komunitet, si kopshte dhe çerdhe; promovimin dhe punësimin e grave në institucione të nivelit vendor dhe qendror; rritjen e ndihmesës së burrave në shtëpi; krijimin e shtysave për gratë që ato të hapin bizneset e tyre, dhe krijimin e mundësive që gratë të punojnë nga shtëpia. Ndërhyrjet që synojnë rritjen e ndihmesës së djemve dhe burrave në familje duhet të përqendrohen në: përfshirjen e burrave dhe djemve në punët e shtëpisë; nxitjen e burrave dhe djemve që të marrin përsipër përgjegjësi të kujdesit për fëmijët; dhe mbështetjen e lejes së atësisë. Ndërhyrje të tjera – të cilat u sugjeruan nga të intervistuarit në këtë studim – duhet të përqendrohen tek: edukimi i djemve që në moshë të vogël me qëndrime barazimtare, puna me anëtarët e familjes që nuk i lejojnë gratë të punojnë; rritja e ndihmës së shtetit për gratë; ndryshimi i qëndrimeve të shoqërisë ndaj rolit të grave në shoqëri; dhe shtimi i mbështetjes familjare për përparimin e grave në karrierë.

Tabela e Lëndës

| | |
|---|-----------|
| HYRJE | 11 |
| METODOLOGJIA | 14 |
| KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT | 16 |
| GJETJET | 17 |
| Ndarja e detyrave në familje | 17 |
| Përgjegjësitë për mirërritjen e fëmijëve..... | 25 |
| Roli grave dhe burrave në familje..... | 29 |
| Punësimi | 33 |
| Menaxhimi i parave | 34 |
| Balanca karrierë – familje | 35 |
| Fushat e ndërhyrjes | 39 |
| PËRFUNDIME DHE DISKUTIME | 41 |
| REFERENCA | 44 |
| SHTOJCA 1 | 47 |
| SHTOJCA 2 | 48 |
| SHTOJCA 3 | 58 |

Lista e figurave

Figura 1: Larja dhe hekurosja e rrobave

Figura 2: Pastrimi i shtëpisë

Figura 3: Bërja e pazareve

Figura 4: Gatimi

Figura 5: Larja e enëve

Figura 6: Hedhja e mbeturinave

Figura 7: Riparimet mirëmbajtëse në shtëpi

Figura 8: Pagimi i faturave

Figura 9: Kujdesi për të sëmurët në familje

Figura 10: Numri mesatar i orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë sipas gjinisë

Figura 11: Numri mesatar i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët për punët e shtëpisë, sipas gjinisë

Figura 12: Kujdesi për fëmijët sipas gjinisë

Figura 13: Qëndrimi me fëmijën e sëmurë sipas gjinisë

Figura 14: Çuarja e fëmijës tek mjeku sipas gjinisë

Figura 15: Vënia e fëmijës në gjumë sipas gjinisë

Figura 16: Çuarja e fëmijës në shkollë/kopsht/kurse sportive sipas gjinisë

Figura 17: Ndihmimi i fëmijës me detyrat e shtëpisë sipas gjinisë

Figura 18: Numri mesatar i orëve të shpenzuara me kujdesin për fëmijët sipas gjinisë

Figura 19: Numri mesatar i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët për kujdesin për fëmijët sipas gjinisë

Figura 20: “Burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë”

Figura 21: “Burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve”

Figura 22: “Është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen”

Figura 23: “Një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje”

Figura 24: Vendimi për numrin e fëmijëve

Figura 25: Gjinia e fëmijës

Figura 26: Përgjegjësitë familjare pengojnë përparimin në karrierë

Figura 27: Anëtarët e familjes mbështesin përparimin në karrierë

Figura 28: Bashkëshorti/partneri e mbështet përparimin në karrierë

Figura 29: “Është mirë nëse gruaja punon, por, mbi të gjitha, ajo duhet të mendojë për familjen dhe fëmijët e saj”⁴⁸

Figura 30: “Burri duhet të sakrifikojë karrierën për familjen”

Figura 31: “Gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen”

Figura 32: “Nëse gruaja fiton më shumë të ardhura se burri, kjo krijon probleme në familje”

Figura 33: Mundësitë për punësim

Figura 34: Parapëlqimi për gjininë e drejtuesit

HYRJE

Gjatë njëzet e pesë viteve të fundit Shqipëria ka pësuar shndërrime të jashtëzakonshme. Kalimi nga një shoqëri e mbyllur në një shoqëri me qasje të hapur, ka sjellë ndryshime të thella në jetën e grave dhe burrave. Arritjet në fushën e barazisë gjinore kanë qenë të shumta.

Qëllimi përfundimtar i këtyre ndryshimeve në institucionet zyrtare – në ligje, rregulla dhe rregullore – është trajtimi i problemit të dallimeve gjinore dhe përmirësimi i rolit të grave në shoqëri. Me gjithë këtë, dallimet gjinore vazhdojnë të ekzistojnë. Sipas Raportit Global për Hendekun Gjinor (*Global Gender Gap Report*, 2014), Shqipëria renditet e 83-ta (nga 142 vende), me një koeficient prej përafërsisht 0,69.¹ Dallimet gjinore janë veçanërisht mjaft të theksuara në sektorin ekonomik. Të ardhurat e burrave vlerësohen të jenë përafërsisht 2 herë më të larta se ato të grave (12 226 USD kundrejt 6 562 USD). Vetëm 23 për qind e grave janë në poste drejtuese – si ligjvënëse, zyrtare të larta apo drejtuese, ndërsa tek burrat kjo përqindje qëndron tek 78%. Krahasuar me burrat, gratë kanë më shumë gjasa të jenë punonjëse teknike dhe jo drejtuese. Përveç kësaj, vetëm 12 për qind e kompanive të vendit kanë një grua si drejtuesen e tyre më të lartë (po aty). Dallimet janë gjithashtu mjaft të theksuara edhe në mundësitë e qasjes në tregje, zotërim pronash dhe pjesëmarrje në proceset politikëbërëse (Dauti dhe Gjermani, 2015;

Halimi dhe Zhllima, 2014; ISB, 2013; Mandro, 2013; SHGPAZ, 2013; Zhllima, 2012, 2013).

Një nga mësimet e nxjerra në demokracitë në zhvillim është se problemi i dallimeve gjinore nuk mund të zgjidhet vetëm përmes ndryshimeve ligjore. Shkalla në të cilën do të kenë sukses ndryshimet ligjore varet, ndër të tjera, edhe nga mënyra si priten ato nga popullata. Gratë sipërmarrëse, për shembull, kanë më pak gjasa të jenë të suksesshme nëse në shoqërinë ku ato jetojnë ekziston bindja e përhapur se grave duhet t'u lihen vetëm role dytësore. Nuk mund të arrihet një qasje e barabartë në tregje dhe mallra në prani të vlerave patriarkale dhe qëndrimeve diskriminuese ndaj grave. Nëse bindjet e njerëzve nuk përputhen me ndryshimet në politika, atëherë do të vijojë një zbatim i dobët i ndryshimeve ligjore (Jorth, 1995).

Kalimi nga rolet tradicionale në role të barasvlershme ndikohet nga faktorë të shumtë. Janë dy qasje që na njohin me modelet e ndryshimit – qasja me bazë interesin dhe ajo me bazë ekspozimin (njohjen). Qasja me bazë interesin thotë interesat e njerëzve i japin formë qëndrimeve të tyre ndaj barazisë gjinore. Për

1. Sa më afër numrit 1 koeficienti, aq më i vogël hendeku gjinor.

shembull, ka më shumë gjasa që gratë, më shumë se sa burrat, të parapëlqejnë një ndarje të barabartë të punëve të shtëpisë dhe të përgjegjësive për rritjen e fëmijëve. Ose, gratë janë më të prira se burrat të mbështesin politikën që ngushtojnë hendekun gjinor në paga, sepse janë ato që përfitojnë drejtpërsëdrejti nga politika të tilla. Edhe të ardhurat mund të ndikojnë gjithashtu në masën në të cilën gratë dhe burrat përqafojnë rolet jo-tradicionale në familje. Në qoftë se burrat fitojnë më pak të ardhura se gratë, ata mund të jenë më pak të interesuar në rolet tradicionale në familje (Bolzendahl dhe Myers, 2004). Ata do të kenë më pak pritshmëri për përfshirjen e grave në punët e shtëpisë dhe përgjegjësitë për rritjen e fëmijëve. Në përgjithësi, kjo qasje sugjeron se ndërhyrjet që fokusohen tek nxitja e barazisë gjinore gjejnë më shumë mbështetje tek grupi që përfiton më shumë prej tyre.

Qasja me bazë ekspozimin (njohjen) përqendrohet tek mënyrat se si mund të ndikojnë përvojat jetësore në qëndrimet e njerëzve ndaj barazisë gjinore. Për shembull, pjesëmarrja e grave në tregun e punës bën që mbështetja e tyre për barazinë gjinore të jetë më e madhe. Gratë që marrin pjesë në tregun e punës bien në kontakt me diskriminimin dhe trajtimin e pabarabartë, çka i bën ato më të ndërgjegjshme për rëndësinë e nxitjes së barazisë gjinore. Edhe arsimit ushtron një ndikim të ngjashëm. Siç vë në dukje Bolzendahl dhe Myers (2004), gratë “mund të përjetojnë ndikimin ‘iluminues’ të arsimit, i cili i kundërvihet stereotipave gjinore dhe ofron interpretime alternative për rolet e grave” (p. 762). Autorë të tjerë kanë konstatuar se qëndrimet e grave ndryshojnë me përmirësimin e nivelit arsimor dhe pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës (Carter *et al.*, 2009; Thornton *et al.*, 1983).

Njohja mund të veprojë edhe përmes një kanali tjetër, që është niveli arsimor i prindërve, veçanërisht niveli arsimor i nënës dhe gjendja e punësimit të saj. Provat tregojnë se kur nëna punon, kjo ndikon pozitivisht në arritjet arsimore të fëmijëve të saj dhe suksesin e tyre në jetën profesionale (McGinn, 2015). Përveç kësaj, djemtë nënat e të cilëve janë në punë, bëjnë më shumë punë shtëpie dhe ka më shumë gjasa të kenë qëndrime barazimtare për rolet gjinore. Nëse jetojnë dhe shoqërizohen në një mjedis ku nuk pranohen stereotipat gjinore, gjasat janë më të mëdha që fëmijët të ndërgjegjësohen për rëndësinë e barazisë gjinore. Qëndrimet e nënave ndaj roleve gjinore dhe përvojat e tyre luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e qëndrimeve dhe pikëpamjeve të fëmijëve (Thornton *et al.*, 1983). Si interesi, ashtu edhe njohja, mund të ndërveprojnë me njëra tjetrën, duke sjellë rezultate që varen nga rrethanat specifike.

Perceptimet për ndarjen e punëve të shtëpisë dhe të përgjegjësive për rritjen e fëmijëve ndikojnë në shkallën se sa të kënaqur janë bashkëshortët nga martesja dhe shkallën e rrezikut të divorcit. Gratë, më shumë se burrat, kanë gjasa ta perceptojnë ndarjen e punëve të shtëpisë si të padrejtë dhe “kjo ndjenjë padrejtësie e pakëson mjaft ndjenjën e të qenit i/e lumtur në familje, si dhe shton shqetësimet dhe vuajtjet psikologjike, mosmarrëveshjet martesore, dhe rrezikun e divorcit tek gratë” (Oláh dhe Gähler, 2014, p. 575). Për më tepër, këto perceptime janë ngushtësisht të ndërthurura me qëndrimet ndaj roleve gjinore. Nëse gratë kanë qëndrime gjinore barazimtare, ato kanë më shumë gjasa ta perceptojnë ndarjen tradicionale të punëve të shtëpisë si të padrejtë. Ndërsa, nëse gratë kanë qëndrime gjinore tradicionale, ato e perceptojnë ndarjen tradicionale të punëve të shtëpisë si të drejtë. Pra, qëndrimet e një individi të caktuar mund të ndikojnë në atë se sa i/e

kënaqur është ai/ajo me ndarjen e punëve të shtëpisë.

Studimi i perceptimeve dhe qëndrimeve të publikut mbi barazinë gjinore në kontekstin e Shqipërisë është i rëndësishëm për arsyet e mëposhtme: Së pari, një kuptim i mirë i mënyrës se si e perceptojnë shqiptarët barazinë gjinore do të ndihmojë për të orientuar ndërhyrjet që synojnë përafrimin e këtyre dy aspekteve: ndryshimeve ligjore dhe qëndrimeve të njerëzve. Për shembull, nëse perceptimi publik nuk e përkrah përfshirjen e grave në biznes, atëherë del si detyrë hartimi i strategjive që synojnë ndryshimin e këtyre perceptimeve. Për shembull, në qoftë se perceptimet e publikut nuk janë në favor të përfshirjes së grave në biznes, detyra do të jetë hartimi i strategjive që synojnë ndryshimin e perceptimeve dhe luftën kundër stereotipave gjinore. Fortin (2005) argumenton se pikëpamjet anti-barazimtare, që e kufizojnë rolin e grave brenda mureve të shtëpisë, ende vazhdojnë të ekzistojnë edhe në vendet e zhvilluara. Studimi i perceptimeve të barazisë gjinore në kohë ndryshimesh institucionale dhe strukturore shërben për të kuptuar forcat e ndërlikuara që e mbajnë gjallë tradicionalizmin. Së dyti, studimi i perceptimeve publike në të gjitha grupet dhe zonat do të ndihmojë për të kuptuar se si lidhen karakteristikat individuale dhe rajonale me këto perceptime. Së treti, studimi i perceptimeve mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve. Për studimin e perceptimeve shpesh ka kritika se ai ofron informacione të anshme, të cilat mund të jenë mjaft të ndryshme nga realiteti (Olken, 2009). Për shembull, njerëzit mund të thonë se i mbështesin

parimet e barazisë gjinore, por në praktikë qëndrimet e tyre janë diskriminuese. Çka raportohet nga njerëzit dhe mënyra se si raportohet, mund të ndikohet nga ajo çka mendohet si shoqërisht e dëshirueshme. Ky studim do të ofrojë disa informacione dhe mendime se si mund të trajtohet kjo çështje nga studimet e ardhshme.

Disa nga pyetjet që do të trajtohen në këtë studim janë: Çfarë lloj bindjesh kanë shqiptarët për sa i përket barazisë gjinore? A ka dallime rajonale? Si ndikojnë dallimet individuale, si për shembull mosha dhe arsimit, në shpjegimin e perceptimeve publike për barazinë gjinore? Cilat janë barrierat që pengojnë integrimin e suksesshëm të grave në tregun e punës? Çfarë lloj ndërhyrjesh mund të nxisin fuqizimin ekonomik të grave? Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, u krye një studim sasior në katër rajone të Shqipërisë – malor, bregdetar, qendror, dhe në zonën e Tiranës (Banka Botërore, 2013). Gjetjet e studimit hedhin dritë mbi ndarjen e punëve në familje, ndarjen e përgjegjësisë për rritjen e fëmijëve, perceptimet dhe qëndrimet ndaj roleve të grave dhe burrave në familje, menaxhimin e parave, balancën karrierë-familje, përvojat në tregun e punës, dhe fushat e ndërhyrjes që mund të nxisin barazinë gjinore në familje dhe në tregun e punës. Gjetjet e këtyre studimeve mund të shërbejnë për të orientuar ndërhyrjet me bazë faktet e konstatuara, që mund të përdoren për të ndikuar në perceptimet publike, për të shtuar mbështetjen për barazinë gjinore, dhe për të ngushtuar hendekun midis ndryshimeve ligjore dhe realiteteve vendore në Shqipëri.

Metodologjia

Për të shqyrtuar perceptimet e publikut mbi barazinë gjinore u krye një studim sasior në katër rajone të Shqipërisë – një rajon malor, një bregdetar, një qendror, dhe një në zonën e Tiranës. Këto zona karakterizohen nga nivele të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror (Banka Botërore, 2013).

Përzgjedhja u bë mbi bazën e hipotezës se niveli i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror është bazë për dallimet në perceptime. Studime të mëparshme kanë treguar, për shembull, se këto katër rajone kanë dallime për sa i përket pjesëmarrjes së grave në politikat vendore (Dauti dhe Gjermani, 2015).

Në secilin rajon u përzgjodhën në mënyrë të rastësishme disa rrethe dhe, më tej, disa njësi administrative, urbane dhe rurale (shih shtojcën 1 për zonat e përzgjedhura). Në secilin rreth u zhvilluan 45 intervista – 25 në zonat urbane (me përjashtim të Tiranës, ku u zhvilluan 50 intervista) dhe 20 intervista në zonat rurale. Gjithsej u zhvilluan 450 intervista në 9 qytete dhe 10 fshatra.

Me ekipin e studimit, i përbërë nga 20 intervistues dhe 2 bashkërendues të punës në terren, u zhvillua një seancë trajnimi dhe dy takime për diskutim. U përgatitën udhëzues të posaçëm për intervistuesit dhe bashkërenduesit e punës në terren. Përveç kësaj, ekipi u pajis edhe me hartat e secilës njësi administrative të përzgjedhur, për të ndihmuar në procesin e përzgjedhjes së kampionit. Përzgjedhja e pjesëmarrësve në studim u bë mbi bazën e ecjeve të rastësishme sipas katër koordinatat gjeografike - veri,

jug, lindje dhe perëndim. Ka disa kritikë që thonë se metoda e ecjeve të rastësishme çon në përzgjedhjen e pjesëmarrësve që janë të gatshëm të marrin pjesë në studim dhe të bashkëpunojnë me intervistuesin (Rubin dhe Babbie, 2013). Ne u përpoqëm ta korrigjojmë këtë të metë duke i këshilluar intervistuesit të vizitonin zonat e periferive dhe të shmangnin qëndrimin afër qendrave të qyteteve/fshatrave.

Ekipi shqyrtoi edhe instrumentet hulumtuese që janë përdorur për matjen e perceptimeve të barazisë gjinore në kontekste të tjera, si Anketa e Përgjithshme Shoqërore (*General Social Survey*), Anketimi Botëror i Vlerave (*World Values Survey*), Anketimi i Perceptimeve Publike për Barazinë Gjinore (*Public Perceptions Survey on Gender Equality*) në shtetin Xhorxhia të SHBA, dhe Eurobarometri për Barazinë Gjinore (*Eurobarometer Survey on Gender Equality*). Instrumenti i hulumtimit u diskutua me aktorë të shumtë dhe pastaj u testua paraprakisht nga secili intervistues me një grup të vogël individësh. Pas kësaj u zhvillua një takim për të diskutuar për instrumentin dhe për t'i bërë ndryshime. Pas përfundimit të punës në terren, u zhvillua një takim tjetër për të diskutuar mbi përvojën e punës në terren.

Intervistat u zhvilluan me individë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Pyetjet u përqendruan tek (a) ndarja e punëve të shtëpisë; (b) përgjegjësia për mirërritjen e fëmijëve; (c) perceptimet dhe qëndrimet ndaj rolit të grave dhe burrave në familje; (d) punësimi dhe të ardhurat; (e) menaxhimi i parave; (f) balanca ndërmjet karrierës dhe familjes; dhe (g) fushat e ndërhyrjes për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës dhe të ndihmesës së burrave dhe djemve në familje.

Për të krijuar një tablo të ndarjes së detyrave në familje, pjesëmarrësit në studim u pyetën për gjininë e anëtarit të familjes që është përgjegjës për detyra tipike, si larja dhe hekurrosja e rrobave, pastrimi i shtëpisë, bërja e pazareve, gatimi, larja e enëve, hedhja e mbeturinave, riparimet mirëmbajtëse në shtëpi, pagimi i faturave, dhe kujdesi për anëtarët e sëmurë të familjes. Përveç kësaj, të intervistuarit u pyetën edhe për numrin e orëve që shpenzonin duke bërë punë shtëpie, numrin e orëve që shpenzonin bashkëshortët/bashkëshortet e tyre për punët e shtëpisë, sa të kënaqur ishin ata/ato vetë me këtë ndarje të detyrave në familje, dhe sa i/e kënaqur ishte bashkëshorti/bashkëshortja me këtë ndarje të detyrave në familje.

Për të kuptuar përgjegjësinë e kujdesit për fëmijët, pjesëmarrësit në studim që kishin fëmijë nën 11 vjeç, u pyetën për gjininë e anëtarit të familjes që kujdeset për fëmijën, që rri me fëmijën në shtëpi kur është sëmurë, e çon fëmijën tek mjeku, e vë fëmijën për të fjetur, e çon fëmijën në kopsht/shkollë/kurse jashtëshkollore dhe e ndihmon fëmijën me detyrat e shtëpisë. Ata u pyetën gjithashtu për numrin e orëve që shpenzojnë duke u kujdesur për fëmijët, numrin e orëve që shpenzon bashkëshorti/bashkëshortja duke u kujdesur për fëmijët, sa të kënaqur janë të intervistuarit me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit

për fëmijët, dhe sa të kënaqur janë bashkëshortët/partnerët e tyre me ndarjen e përgjegjësive të përkujdesit për fëmijët.

Për të ngërthyer perceptimet dhe qëndrimet ndaj rolit të grave dhe burrave në familje, pjesëmarrësit në studim u pyetën se sa ishin dakord (në një shkallë nga 'aspak dakord' deri në 'shumë dakord') me disa pohime si "burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve", "është më mirë për të gjithë familjen nëse burri ka një punë dhe gruaja kujdeset për familjen" dhe "burrat duhet të përfshihen po aq sa gratë në punët e shtëpisë." Pyetje të tjera u përqendruan në numrin e fëmijëve dhe parapëlqimet për gjininë e fëmijës.

Për të ngërthyer balancën karrierë-familje, pjesëmarrësit në studim u pyetën se sa ishin dakord (në një shkallë nga 'aspak dakord' deri në 'shumë dakord') me një numër pohimesh, si: "është mirë që gruaja të punojë, por para së gjithash ajo duhet të mendojë për familjen dhe fëmijët e saj", "bashkëshorti duhet të sakrifikojë karrierën për familjen", "gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen" dhe "nëse gruaja fiton më shumë të ardhura se bashkëshorti i saj, kjo krijon probleme në familje." Ata u pyetën gjithashtu se sa mundësi kanë burrat dhe gratë të gjejnë punë, si dhe parapëlqimet e tyre për gjininë e drejtorit në një mjedis pune hipotetik. Pyetjet u përqendruan edhe në shkallën në të cilën e pengojnë përparimin e grave në karrierë përgjegjësitë familjare, si dhe përkrahjen që kanë burrat dhe gratë nga anëtarët e familjes.

U mblodhën gjithashtu edhe të dhëna për karakteristika të nivelit individual, si mosha, gjinia, feja, gjendja civile, niveli arsimor i bashkëshortit/bashkëshortes, numri i fëmijëve, numri i fëmijëve nën 11 vjeç, numri i familjeve që banojnë nën të

njëjtën çati, dhe marrëdhëniet me kryefamiljarin. Po kështu, pjesëmarrësit në studim u pyetën nëse i përkisnin ndonjë grupi të pakicës si dhe nëse përfitonin asistencë për shkak të aftësive të kufizuara. Intervistuesit mbajtën shënime informacione për qarkun, rrethin, bashkinë/komunën dhe llojin e zonës (urbane apo rurale).

Për të shqyrtuar marrëdhëniet ndërmjet karakteristikave individuale dhe atyre në nivel rajonal dhe perceptimeve të publikut u kryen analiza univariate dhe bivariate (*testi hi në katror, testi-T, korrelacion, anova*). Të dhënat u hodhën në *Access* nga dy asistentët e studimit dhe më tej u kaluan në *STATA/SE 12.1*, ku edhe u bë analizimi i tyre. U krye një analizë tematike për të kuptuar mundësitë e grave dhe burrave në tregun e punës, dhe parapëlqimet e tyre në lidhje me gjininë e drejtuesit.

Karakteristikat e kampionit

55,56 për qind e personave të intervistuar (n = 250) jetonin në zona urbane, 49,33 për qind (n = 222) ishin gra dhe 79,33 për qind (n = 357) ishin

të martuar. 45,33 për qind (n = 204) raportuan se kishin përfunduar shkollën e mesme. Vetëm 18,22 për qind e personave të intervistuar (n = 82) ishin me arsim të lartë. 73,6 për qind (n = 329) e të intervistuarve nuk kishin fëmijë nën moshën 11 vjeç. Pjesa më e madhe e të intervistuarve, 40,85 për qind (n = 183), ishin kryefamiljarë, ndjekur nga bashkëshort/e, me 35,71 për qind (n = 160), dhe një nga fëmijët, 15,40 për qind (n = 69). 9,89 për qind e personave të intervistuar (n = 44) raportuan se përfitonin asistencë për aftësi të kufizuara dhe 5,13 për qind (n = 23) raportuan se i përkisnin një grupi të pakicës (shih Tabelën 1).

Numri mesatar i fëmijëve ishte 2,4 (*DS* = 1,82; *intervali* = 0 – 10). Numri mesatar i familjeve që jetonin nën të njëjtën çati ishte 1,27 (*DS* = 0,61; *intervali* = 0 – 5). 25,11 për qind e pjesëmarrësve të studimit (n = 113) raportuan se kishin jetuar jashtë shtetit. Numri mesatar i viteve të jetuara jashtë shtetit ishte 5,96 (*DS* = 5,26). Më se 40 për qind e personave të intervistuar raportuan se ishin të punësuar; 77,89 për qind e atyre që ishin të punësuar (n = 155) thanë se punonin në sektorin privat (shih Tabelën 2).

GJETJET

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar – më se 80 për qind – raportuan se zakonisht ishin gratë ato që bënin larjen dhe hekurosjen e rrobave, pastrimin e shtëpisë, gatimin, dhe larjen e enëve. Dy punët e shtëpisë ku burrat kishin gjasa të ishin më të angazhuar se gratë lidheshin me riparimet në shtëpi dhe pagimin e faturave


Ndarja e detyrave në familje

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar – më se 80 për qind – raportuan se zakonisht ishin gratë ato që bënin larjen dhe hekurosjen e rrobave, pastrimin e shtëpisë, gatimin, dhe larjen e enëve. Dy punët e shtëpisë ku burrat kishin gjasa të ishin më të angazhuar se gratë lidheshin me riparimet në shtëpi dhe pagimin e faturave. Gratë dhe burrat zakonisht ndanin më shumë së bashku detyrat e mëposhtme: hedhjen e mbeturinave, pazaret, dhe përkujdesin për anëtarët e sëmurë të familjes. Faktorë të tjerë përveç gjinisë që lidheshin me ndarjen e punëve të shtëpisë ishin arsimi, gjendja civile dhe përvojat në migrim.

Larja dhe hekurosja e rrobave

Përafërsisht 90 për qind e personave të intervistuar (n = 400) raportuan se zakonisht janë gratë ato që lajnë dhe hekurosin rrobat. Vetëm 9,11 për qind e personave të intervistuar (n = 41) raportuan se “larja dhe hekurosja e rrobave” është një detyrë që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 1).

Për të shqyrtuar marrëdhëniet ndërmjet llojit të rajonit



(urban kundrejt rural) dhe “larjes dhe hekurosjes së rrobave” u krye testi hi në katror. Nuk kishte ndonjë dallim statistikisht domethënës ndërmjet të intervistuarve në zonat urbane dhe atyre nga zonat rurale. Po kështu, nuk kishte ndonjë dallim statistikor ndërmjet grave dhe burrave. Marrëdhënia ndërmjet gjendjes civile dhe “larjes dhe hekurosjes së rrobave” ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit e martuar kishin më shumë gjasa të raportonin se

zakonisht “larjen dhe hekurosjen e rrobave” e bënin gratë. Marrëdhënia ndërmjet arsimit dhe “larjes dhe hekurosjes së rrobave” nuk ishte statistikisht domethënëse. Pavarësisht nga kjo, përqindja e personave të intervistuar që raportuan se përgjegjësitë janë të ndara pothuajë barabar ndërmjet grave dhe burrave ishte më e lartë ndër personat me nivel më të lartë arsimor. Përqindja e personave të intervistuar me arsim universitar e lart, që thanë se gratë dhe burrat i ndajnë këto përgjegjësi pothuajë barabar, ishte dy herë më e lartë se përqindja e të intervistuarve me arsim të mesëm e poshtë, përkatësisht 13,95 për qind dhe 6,88 për qind (shih Tabelën 33).

Pastrimi i shtëpisë

84 për qind e pjesëmarrësve në studim (n = 378) raportuan se pastrimin e shtëpisë e bëjnë zakonisht gratë. 14,67 për qind e pjesëmarrësve në studim thanë se “pastrimi i shtëpisë” ndahet pothuajë barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 2).



Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “pastrimit të

shtëpisë” ishte statistikisht domethënëse. Krahasuar me burrat, gratë kishin më shumë gjasa raportonin se “pastrimi i shtëpisë bëhet zakonisht nga gratë.” Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin pastrimi i shtëpisë ishte përgjegjësi që ndahej ndërmjet tyre dhe grave, përkatësisht 19,74 për qind me 9,46 për qind. Përqindja më e madhe e atyre që raportuan se i ndanin përgjegjësitë me partnerin/partneren e tyre ishte ndër të intervistuarit me nivel arsimor më të lartë (shih Tabelën 34).

Bërja e pazareve

36,89 për qind e personave të intervistuar (n = 166) thanë se pazaret i bëjnë zakonisht gratë, ndërsa 43,11 për qind (n = 194) thanë se bërja e pazareve ndahet pothuajë barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 3).

Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “bërjes së pazareve” ishte statistikisht domethënëse. Krahasuar me burrat, gratë kishin më shumë gjasa të raportonin se “pazaret i bëjnë zakonisht gratë.” Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin se pazarin e bënin ata vetë;



44,14 për qind e grave raportuan se zakonisht pazarin e bënin gratë, ndërkohë që përqindja e burrave që raportuan se pazarin e bënin zakonisht gratë ishte 29,82%. Ndërsa 23,35 për qind e burrave raportuan se pazarin e bënin zakonisht burrat, përqindja e grave që raportuan se pazarin e bëjnë zakonisht burrat ishte 14,86. Të intervistuarit me përvojë migrimi kishin më shumë gjasa të raportonin se kjo detyrë ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 35).

Gatimi



82,14 për qind e pjesëmarrësve në studim (n = 368) raportuan se gatimin zakonisht e bënin gratë; 16,29 për qind (n = 73) raportuan se gatimi ndahej barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 4).

Përafërsisht 90 për qind e personave të intervistuar në rajonet malore raportuan se “gatimin e bëjnë zakonisht gratë.” Marrëdhënia ndërmjet gjendjes civile dhe gatimit ishte statistikiisht domethënëse. Të intervistuarit e martuar, krahasuar me ata të pamartuar, kishin më shumë gjasa të raportonin

se “gatimin e bëjnë zakonisht gratë.” Marrëdhënia ndërmjet nivelit arsimor dhe gatimit ishte statistikiisht domethënëse. Të intervistuarit me nivel më të lartë arsimor kishin më shumë gjasa të raportonin se gatimi ishte përgjegjësi që ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Të intervistuarit me arsim të mesëm e poshtë kishin më shumë gjasa të raportonin se “gatimin e bëjnë zakonisht gratë.” Në veçanti, 85,53 për qind e personave të intervistuar me arsim të mesëm e poshtë raportuan se “gatimin e bëjnë zakonisht gratë.” Ndërkohë, kjo përqindje për të intervistuarit me arsim universitar e lart ishte 70,93. Përqindja e personave të intervistuar që raportuan se gatimi ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave ishte dy herë më e madhe ndër personat me arsim universitar e lart se sa ndër të intervistuarit me arsim të mesëm e poshtë. Të intervistuarit me përvojë migrimi kishin më shumë gjasa të raportonin se gatimi ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 36).

Larja e enëve

88,44 për qind e personave të intervistuar (n = 398)




thanë se enët zakonisht i lanin gratë; 9,78 për qind (n = 44) thanë se detyra e "larjes së enëve" ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Më pak se 0,5 për qind e personave të intervistuar raportuan se enët i lante gjyshi dhe gjyshja (shih Figurën 5).

Marrëdhënia ndërmjet rajonit dhe larjes së enëve nuk ishte statistikisht domethënëse. Megjithatë, kishte një përqindje më të madhe të personave të intervistuar në zonën malore që raportuan se "larjen e enëve e bëjnë zakonisht gratë." Një përqindje më e madhe e personave të intervistuar në kryeqytet raportuan se larja e enëve ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Po kështu, një përqindje më e madhe e personave të intervistuar në zonat urbane raportuan se larja e enëve ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe "larjes së enëve" ishte statistikisht domethënëse. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportonin që "enët zakonisht i lajnë gratë." Më konkretisht, 93,69 për qind e grave raportuan se "enët zakonisht i lajnë gratë" krahasuar me 83,33 për qind të burrave që thanë se "enët zakonisht i lajnë gratë." Burrat kishin më shumë gjasa të raportonin se larja e enëve është përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Përqindja e burrave që raportuan se larja e enëve është përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave ishte pothuaj 3 herë më e madhe se përqindja e grave që thanë të njëjtën gjë, përkatësisht 14,04 për qind dhe 5,41. Marrëdhënia ndërmjet nivelit arsimor dhe "larjes së enëve" nuk ishte statistikisht domethënëse. Megjithatë, kishte një përqindje më të madhe të intervistuarish me nivel më të larta arsimor që raportuan se detyra e larjes së enëve ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. I njëjti përfundim është i vërtetë edhe për nivelin arsimor të partnerit/partneres (shih Tabelën 37).

Hedhja e mbeturinave

31,39 për qind e pjesëmarrësve në studim (n = 140) raportuan plehrat zakonisht i hedhin gratë; 23,99 për qind (n = 107) raportuan se këtë gjë e bëjnë zakonisht burrat; dhe 43,05 për qind (n = 192) raportuan se "hedhja e mbeturinave" ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 6).

Marrëdhënia ndërmjet rajonit dhe "hedhjes së mbeturinave" nuk ishte statistikisht domethënëse. Megjithatë, kishte një përqindje më të madhe të të intervistuarve nga rajoni malor që raportuan se "mbeturinat zakonisht i hedhin gratë." Një përqindje më e madhe e personave të intervistuar nga Tirana dhe rajoni qendror raportuan se detyra e nxjerrjes së plehrave është një përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Marrëdhënia ndërmjet llojit të rajonit (urban kundrejt rural) dhe "hedhjes së mbeturinave" ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit në zonat rurale, krahasuar me ata në zonat urbane, kishin më shumë gjasa të raportonin se "mbeturinat i hedhin zakonisht gratë," përkatësisht 38,89 për qind dhe 25,40. Edhe




marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “hedhjes së mbeturinave” ishte statistikisht domethënëse. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportnin që “mbeturinat i hedhin zakonisht gratë.” Përqindja e grave që raportuan se “mbeturinat hidhen zakonisht nga gratë” ishte përafërsisht dy herë më e madhe se përqindja e burrave. Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportnin se “mbeturinat i hedhin zakonisht burrat.” Marrëdhënia ndërmjet nivelit arsimor dhe “hedhjes së mbeturinave” ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit me nivele më të larta arsimore kishin më shumë gjasa të raportnin se “hedhja e mbeturinave” është përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. I njëjti përfundim qëndron edhe për të intervistuarit me përvojë migrimi (shih Tabelën 38).

Riparimet mirëmbajtëse në shtëpi

4,50 për qind e personave të intervistuar (n = 20) thanë se me riparimet në shtëpi merreshin zakonisht gratë; 77,25 për qind (n = 343) thanë se me riparimet e shtëpisë merreshin zakonisht burrat; dhe 11,94 për

qind (n = 53) thanë se këtë detyrë e bënin si gratë dhe burrat. Një numër i vogël i të intervistuarve, 6,08 për qind (n = 27), mbështeteshin në burime të jashtme (shih Figurën 7).

Marrëdhënia ndërmjet rajonit dhe “riparimeve në shtëpi” ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit në zonat malore kishin më shumë gjasa të raportnin që “me riparimet në shtëpi merren zakonisht burrat.” Ndërsa personat e intervistuar në Tiranë dhe në zonat bregdetare kishin më shumë gjasa të raportnin që kjo detyrë ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Nuk kishte dallim ndërmjet zonave urbane dhe rurale, dhe as ndërmjet grave dhe burrave. Gratë e martuara kishin më pak gjasa të raportnin që “me riparimet në shtëpi merren zakonisht gratë.” Kjo është e pritshme sepse grupi tjetër – gratë e pamartuara, ku përfshihen ato beqare, të divorcuara, ose të veja – duhet të mbështeten tek vetja ose burimet e jashtme. Marrëdhënia ndërmjet nivelit arsimor dhe “riparimeve në shtëpi” ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit me nivele më të larta arsimore kishin më pak gjasa të raportnin që detyra e riparimeve në shtëpi shtëpisë është përgjegjësi vetëm e gruas (shih Tabelën 39).



Pagimi i faturave



16,07 për qind (n = 72) e personave të intervistuar raportuan se pagimi i faturave bëhet zakonisht nga gratë; 56,70 për qind (n = 254) thanë se bëhej zakonisht nga burrat; dhe 24,55 për qind (n = 110) thanë se ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 8).

Marrëdhënia ndërmjet rajonit dhe “pagimit të faturave” ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit në rajonin bregdetar kishin më shumë

gjasa të raportonin se “faturat zakonisht i paguajnë gratë.” Të intervistuarit në zonat malore kishin më shumë gjasa të raportonin se “zakonisht faturat i paguajnë burrat.” Të intervistuarit në Tiranë kishin më shumë gjasa të raportonin që pagimi i faturave është përgjegjësi që ndahet barabar ndërmjet grave dhe burrave. Marrëdhënia ndërmjet llojit të rajonit (urban kundrejt rural) dhe “pagesës së faturave” ishte statistikisht domethënëse. Të intervistuarit në zonat rurale kishin më shumë gjasa të raportonin se “zakonisht faturat i paguajnë burrat.” Po kështu, edhe marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “pagesës së faturave” ishte statistikisht domethënëse. Krahasuar me gratë, burrat kishin më shumë gjasa të raportonin se “faturat i paguajnë zakonisht burrat.” 63 për qind e burrave raportuan se “faturat zakonisht i paguajnë burrat”, kurse ndër gratë kjo përqindje ishte 50,23%. Ishte më e madhe përqindja e të intervistuarve me nivele më të larta arsimore që thanë se detyra e pagimit të faturave ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 40).

Kujdesi për të sëmurët në familje

24,15 për qind (n = 99) e pjesëmarrësve në studim raportuan se për të sëmurët në familje kujdesen zakonisht gratë; 10,73 për qind (n = 44) raportuan se këtë e bëjnë zakonisht burrat; dhe 57,56 për qind (n = 236) thanë se kjo detyrë ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Figurën 9). Marrëdhënia ndërmjet llojit të rajonit (urban kundrejt rural) dhe “kujdesit për të sëmurët në familje” ishte statistikisht domethënëse. Më se 50 për qind e personave të intervistuar, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, thanë se detyra e “kujdesit për të sëmurët në familje” është përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Gratë e martuara, krahasuar me ato të pamartuara, kishin më shumë gjasa të raportonin që “kujdesi për të sëmurët në familje” është përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Ishte më e madhe përqindja e të intervistuarve me nivele të larta arsimore që raportuan se “kujdesi për të sëmurët në familje” është përgjegjësi që ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 41).



Numri i orëve në ditë që shpenzohen për punët e shtëpisë në familje

Numri mesatar i orëve të shpenzuara në ditë për punët e shtëpisë është 3,35 ($DS = 2,69$; *intervali*: 0 – 20). Ky numër ishte pak më i madh për bashkëshortët/partnerët, 3,59 orë ($DS = 3,34$; *intervali*: 0 – 20). Të intervistuarit në zonat rurale raportuan se shpenzonin më shumë kohë me punët e shtëpisë ($M = 3,86$; $DS = 2,97$) se sa të intervistuarit në zonat urbane ($M = 2,96$; $DS = 2,39$). Dallimi ndërmjet dy grupeve ishte statistikisht domethënës (shih Tabelën 42). Gratë raportuan se shpenzonin më shumë orë me punët e shtëpisë ($M = 4,66$; $DS = 2,71$) se sa burrat ($M = 2,07$; $DS = 1,97$). Diferenca ndërmjet grave dhe burrave ishte statistikisht domethënëse (shih Figurën 10).

Gratë e martuara raportuan se shpenzonin më shumë orë për punët e shtëpisë ($M = 3,55$, $DS = 2,16$) se ato të pamartuara ($M = 2,62$; $DS = 2,79$). Dallimi ishte statistikisht domethënës. Të intervistuarit me arsim universitar e lart raportuan se shpenzonin më pak orë me punët e shtëpisë ($M = 2,73$; $DS = 2,24$) se të intervistuarit me nivele më të ulëta arsimore ($M = 3,51$; $DS = 2,78$). Dallimi ishte statistikisht domethënës. Po kështu, të intervistuarit me përvojë migrimi raportuan

se shpenzonin më pak orë për punët e shtëpisë (shih Tabelën 42). Marrëdhënia ndërmjet të ardhurave individuale dhe numrit të orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë ishte e zhdrejtë. Me fjalë të tjera, me rritjen e të ardhurave individuale, numri i orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë pakësohet. Ky përfundim është i vërtetë vetëm për të ardhurat në nivel individual (jo për të ardhurat apo shpenzimet në nivel familjar). Marrëdhënia ndërmjet numrit të fëmijëve dhe numrit të orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë ishte pozitive. Me rritjen e numrit të fëmijëve, rritet edhe numri i orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë. I njëjti përfundim vlen edhe për sa i përket madhësisë së familjes. Sa më e madhe të ishte familja, aq më i madh ishte numri i orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë. Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe numrit të orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë nuk ishte statistikisht domethënëse (shih Tabelën 43).

Numri i orëve të shpenzuara në ditë nga bashkëshortët/partnerët për punët e shtëpisë

Personat e intervistuar në zonat rurale raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre shpenzonin më

Figura 10: Numri mesatar i orëve të shpenzuara për punët e shtëpisë sipas gjinisë





Figura 11: Numri mesatar i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët për punët e shtëpisë, sipas gjinisë



shumë orë për punët e shtëpisë ($M = 4,22$; $DS = 3,60$) se sa të intervistuarit në zonat urbane ($M = 3,01$; $DS = 2,98$). Dallimi ndërmjet dy grupeve ishte statistikisht domethënës. Burrat raportuan se partneret/partneret e tyre shpenzonin më shumë orë për punët e shtëpisë, ($M = 5,69$; $DS = 3,03$) se sa gratë ($M = 1,35$; $DS = 1,86$) (shih Tabelën 44). Dallimi ndërmjet dy grupeve ishte statistikisht domethënës (shih Figurën 11).

Sa më i madh numri i fëmijëve nën moshën 11 vjeç, aq më i vogël ishte numri i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët për punët e shtëpisë (shih Tabelën 45). Me rritjen e moshës së fëmijëve, numri i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët për punët e shtëpisë rritej.

Niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë

Vlera mesatare e nivelit të të qenit i/e kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë ishte 4 ($DS = 1,17$;


intervali: 1 – 5). Vlera mesatare e nivelit të të qenit i/e kënaqur të bashkëshortëve/partnerëve me punët e shtëpisë ishte 4,21 ($DS = 1,07$; *intervali: 1 – 5*). Përafërsisht 80 për qind e pjesëmarrësve në studim janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë (shih Tabelën 4). Po kështu, pjesa më e madhe e të intervistuarve raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre ishin të kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë. Gratë kishin më pak gjasa të ishin të kënaqura me ndarjen e punëve të shtëpisë ($M = 3,80$, $DS = 1,20$) se burrat ($M = 4,19$, $DS = 1,11$). Nuk kishte dallime në nivelin të qenit të kënaqur sipas llojit të rajonit (urban kundrejt rural), gjendjes civile (i/e martuar kundrejt i/e pamartuar), nivelit arsimor (universitar e lart kundrejt niveleve më të ulëta arsimore), dhe nivelit arsimor të partnerit (universitar e lart kundrejt niveleve më të ulëta arsimore) (shih Tabelën 46). Sa më i madh ishte numri i fëmijëve nën 11 vjeç, aq më e ulët ishte niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë. Me rritjen e moshës rritej edhe niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e punëve të shtëpisë (shih Tabelën 47).

Përgjegjësitë për rritjen e fëmijëve

Në fushën e kujdesit për fëmijët ekzistonte një ndarje e thellë gjinore. Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportnin se kujdeseshin për fëmijët së bashku me bashkëshortet/partneret e tyre. Ndërkohë, gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportnin se ato kujdeseshin për fëmijët dhe nuk kishin asnjë lloj ndihme nga burrat. Gratë dhe burrat kishin më shumë gjasa t'i ndanin bashkë përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët në rastet e emergjencave shëndetësore.

Ndihma në kujdesin për fëmijët

Më pak se 40 për qind e personave të intervistuar raportuan se nuk kishin asnjë lloj ndihme për kujdesin e fëmijëve. Ata që kishin ndihmë, kryesisht mbështeteshin tek prindërit e tyre ose prindërit e bashkëshortëve/partnerëve (shih Tabelën 5).




Kujdesi për fëmijët

Rreth 50 për qind e personave të intervistuar raportuan se kujdeseshin për fëmijët nën moshën 11 vjeç së bashku me bashkëshortin/partnerin e tyre (shih Tabelën 6). Megjithatë, këtu u vu re një ndarje të thellë gjinore. Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportnin se kujdeseshin për fëmijët së bashku me bashkëshortin/partnerin: 60,47 për qind kundrejt 41,89 për qind. Ndërkohë, gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportnin se ato kujdeseshin për fëmijët vetë dhe nuk kishin ndihmë nga burrat (shih Tabelën 48). Gratë dhe burrat kishin më shumë gjasa t'i ndanin së bashku përgjegjësitë e rritjes së fëmijëve në rastet e emergjencave shëndetësore, kur fëmija ishte i sëmurë.

Kujdesi i përditshëm për fëmijët

18,80 për qind e pjesëmarrësve në studim që kishin fëmijë nën moshën 11 vjeç (n = 22) raportuan se i ndanin detyrat e kujdesit për fëmijët pothuaj barabar (shih Tabelën 7). Kishte një përqindje më të madhe personash të intervistuar në zonat urbane që



thoshin se kujdesi për fëmijët ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “kujdesit për fëmijët” ishte statistikisht domethënëse. 86,49 për qind e grave raportuan se ishin ato që “kujdeseshin për fëmijën”; ndërkohë, vetëm 4 burra (9,30 për qind) raportuan se ishin ata që “kujdeseshin për fëmijën.” Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin që “kujdesi për fëmijët” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Përqindja e burrave që raportuan se “kujdesi për fëmijët” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave ishte përafërsisht dy herë më i lartë se sa përqindja e grave, përkatësisht 27,91 për qind dhe 13,51 për qind (shih Figurën 12).

Një përqindje më e madhe e të intervistuarve me arsim të lartë raportuan se “kujdesi për fëmijët” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Po kështu, ishte më e madhe përqindja e të intervistuarve me përvojë migrimi që raportuan se “kujdesi për fëmijët” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 48).

Qëndrimi me fëmijën e sëmurë

Më se gjysma e personave të intervistuar me fëmijë nën moshën 11 vjeç - 54,70 për qind (n = 64) - raportuan se “qëndrimi në shtëpi me fëmijën e sëmurë” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 7). Marrëdhënia ndërmjet llojit të rajonit dhe “qëndrimit me fëmijën e sëmurë” nuk ishte statistikisht domethënëse. Megjithatë, kishte një përqindje më të madhe të intervistuarish në zonat urbane që raportuan se “qëndrimi me fëmijën e sëmurë” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave. Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “qëndrimit me fëmijën e sëmurë” ishte statistikisht domethënëse. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportonin se ishin ato që “qëndronin me fëmijën e sëmurë,” përkatësisht 48,65 për qind dhe 6,98 për qind. Krahasuar me gratë, burrat kishin më shumë gjasa të raportonin se “qëndrimi me fëmijën e sëmurë” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave, me përkatësisht 62,79 për qind dhe 50,00 për qind (shih Tabelën 49).

Figura 14: Çuarja e fëmijës tek mjeku sipas gjinisë





Figura 15: Vënia e fëmijës në gjumë sipas gjinisë



Çuarja e fëmijës tek mjeku

64,96 për qind e personave të intervistuar me fëmijë nën moshën 11 vjeç (n = 76) raportuan se “çuarja e fëmijës tek mjeku” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 7). Marrëdhënia ndërmjet karakteristikave në nivel individual dhe rajonal dhe “çuarjes së fëmijës tek mjeku” nuk ishte statistikisht domethënëse. Si gratë, ashtu edhe burrat mobilizoheshin për ta çuar fëmijën tek mjeku (shih Figurën 14). Nuk kishte dallime sipas rajonit, gjinisë, arsimit, apo nivelit arsimor të partnerit (shih Tabelën 50).



Vënia e fëmijës në gjumë

27,68 për qind e personave të intervistuar me fëmijë nën moshën 11 vjeç (n = 31) raportuan se “vënia e fëmijës në gjumë” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 7). Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe vënies së fëmijës në gjumë ishte statistikisht domethënëse. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportnin se ato “e vinin

fëmijën në gjumë.” 67,61 për qind e grave raportuan se e vinin fëmijën në gjumë, ndërkohë që tek burrat kjo përqindje ishte 17,07 (shih Figurën 15). Kishte një përqindje më të lartë të individëve me nivele më të larta arsimore që raportuan se “vënia e fëmijës në gjumë” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 51).

Çuarja e fëmijës në shkollë/kopsht/kurse sportive

29,91 për qind e personave të intervistuar me fëmijë nën moshën 11 vjeç (n = 32) raportuan se “çuarja e fëmijës në shkollë/kopsht/kurse sportive” ishte një detyrë që ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 7). Marrëdhënia ndërmjet karakteristikave në nivel individual dhe rajonal dhe “çuarjes së fëmijës në shkollë/kopsht/kurse sportive” nuk ishte statistikisht domethënëse (shih Tabelën 52). Me fjalë të tjera, ndarja e kësaj detyre nuk paraqiste dallime sipas tipit të rajonit, gjinisë dhe arsimit (shih Figurën 16 për një shembull për ndarjen gjinore).



Ndihmimi i fëmijës me detyrat e shtëpisë

35,24 për qind e pjesëmarrësve në studim me fëmijë nën moshën 11 vjeç ($n = 47$) raportuan se “ndihmimi i fëmijës me detyrat e shtëpisë” ndahej pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 7). Kishte një përqindje më të madhe të intervistuarish në zonat urbane që raportuan se “e ndihmonin fëmijën me detyrat e shtëpisë.” Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe “ndihmimi i fëmijës me detyrat e shtëpisë” ishte statistikisht domethënëse. Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të raportnin që ato “e ndihmonin fëmijën me detyrat e shtëpisë” (shih Tabelën 53). Përqindja e grave që thanë se ato “e ndihmonin fëmijën me detyrat e shtëpisë” ishte 62,69; ndërkohë që për burrat kjo përqindje ishte 13,16 (shih Figurën 17).

Numri i orëve të shpenzuara me kujdesin për fëmijët

Numri mesatar i orëve të shpenzuara me kujdesin për fëmijët nën moshën 11 vjeç ishte 4 ($DS = 2,82$; *intervali*: 1 – 15). Numri mesatar i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët me kujdesin për fëmijët nën moshën 11 vjeç ishte 3,23 ($DS = 2,85$; *intervali*: 0

– 15) (shih Tabelën 8). Gratë raportuan se shpenzonin mesatarisht 4,65 orë ($DS = 3,22$) duke u kujdesur për fëmijët; ndërkohë që burrat raportuan mesatarisht 2,91 orë ($DS = 1,41$) (shih Figurën 18). Dallimi ndërmjet dy grupeve ishte statistikisht domethënëse (shih Tabelën 54).

Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe numrit të orëve të shpenzuara për t’u kujdesur për fëmijët ishte e zhdrejtë. Me fjalë të tjera, siç pritej, me rritjen e moshës, numri i orëve të shpenzuara për kujdesin e fëmijëve ulej.

Numri i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët me kujdesin për fëmijët

Burrat raportuan se bashkëshortet/partneret e tyre shpenzojnë mesatarisht 5,65 orë në ditë ($DS = 3,14$) duke u kujdesur për fëmijët. Ndërkohë, vetë gratë raportuan mesatarisht 4,65 orë në ditë. Gratë raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre shpenzonte 1,83 orë në ditë ($DS = 1,33$) duke u kujdesur për fëmijët, kurse burrat raportuan një mesatare prej 2,91 orësh (shih Figurën 19, Tabela 54, Tabela 55).

Figura 18: Numri mesatar i orëve të shpenzuara me kujdesin për fëmijët sipas gjinisë





Figura 19: Numri mesatar i orëve të shpenzuara nga bashkëshortët/partnerët për kujdesin për fëmijët sipas gjinisë



Niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar ishin të kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët. Përafërsisht 80 për qind e personave të intervistuar raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët. Gratë kishin më pak gjasa të ishin të kënaqura me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët ($M = 3,79$, $DS = 1,21$) se sa burrat ($M = 4,44$, $DS = 1,03$). Të intervistuarit në zonat urbane kishin më shumë gjasa të ishin të kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët ($M = 4,61$, $DS = ,60$) se të intervistuarit në zonat rurale ($M = 4,13$, $DS = 1,14$) (Tabela 58). Sa më i madh ishte numri i fëmijëve, aq më i ulët niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët (Tabela 59).

Sa i/e kënaqur është bashkëshorti/partneri me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët

Pjesa më e madhe e të intervistuarve raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre ishin të kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët. Më konkretisht, 91,75 për qind e pjesëmarrësve në studim thanë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët (shih Tabelën 8). Sa më i madh ishte numri i fëmijëve, aq më pak të kënaqur ishin bashkëshortët me ndarjen e përgjegjësive të kujdesit për fëmijët. Po kështu, sa më e madhe familja, aq më i ulët niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e përgjegjësive të përkujdesit për fëmijët (shih Tabelën 61).

Roli grave dhe burrave në familje

Burimet kryesore të të ardhurave në familje

Personi i intervistuar dhe bashkëshorti/partneri i tyre përbëjnë burimet kryesore të të ardhurave në familje; pas tyre vijnë djemtë dhe babai (shih Tabelën 9).

Fituesi i jetesës

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar, 76,00 për qind ($n = 342$), raportuan se si burrat edhe gratë, duhet të punojnë për të fituar jetesën; 22,67 për qind e personave të intervistuar ($n = 102$) raportuan se jetesën duhet ta fitojnë burrat (shih Tabelën 10).

Qëndrimet ndaj roleve të grave dhe burrave në familje

Të intervistuarit kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje,” ndjekur nga pohimi “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen.” Ndërkohë, të intervistuarit kishin më pak gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë,” ndjekur nga pohimi “burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve.”

“Burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë”

41,78 për qind e personave të intervistuar nuk ishin dakord, ose nuk ishin aspak dakord, me pohimin “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë” (shih Figurën 20).



U vunë re dallime sipas llojit të zonës. 40,4 për qind

e personave të intervistuar në zonat urbane ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë.” 47 për qind e personave të intervistuar në zonat rurale ishin dakord ose shumë dakord me “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë.” Marrëdhënia ndërmjet gjinisë dhe pohimit që “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë” ishte statistikisht domethënëse. Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë.” 49,12 për qind e burrave ishin dakord ose shumë dakord me “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë.” 37,39 për qind e grave ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë” (shih Tabelën 64). Të rriturit në moshë më të madhe kishin më shumë gjasa të pajtoheshin me pohimin “burrat duhet të angazhohen po aq sa gratë në punët e shtëpisë” (shih Tabelën 65).

“Burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve”

Më shumë se 60 për qind e personave të intervistuar (n = 281) ishin dakord ose shumë dakord me “burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve” (shih Figurën 21). Nuk kishte dallime sipas llojit të rajonit, gjinisë, gjendjes civile dhe arsimit (shih Tabelën 62).

58,77 për qind e burrave ishin dakord ose shumë dakord me “burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve.” 66,21 për qind e grave ishin dakord dhe shumë dakord me “burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve.” Kishte disa dallime të vogla sipas nivelit arsimor; 63,95 për qind e personave të intervistuar me arsim universitar e lart ishin dakord ose shumë dakord me “burrat duhet të shpenzojnë po aq kohë sa gratë me rritjen e fëmijëve.” Përqindja e atyre me nivele më të ulëta arsimore ishte 62,08 (shih Tabelën 62).



“Është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen”

Përafërsisht 70 për qind e personave të intervistuar ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen” (shih Figurën 22).

Krahasuar me të intervistuarit në zonat urbane, të intervistuarit në zonat rurale kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen.” 62 për qind e personave të intervistuar në zonat urbane ishin dakord ose shumë dakord me këtë pohim; kurse përqindja për zonat rurale ishte 77,89. Gjinia e personave të intervistuar nuk përbënte ndonjë dallim (nga pikëpamja statistikore). 72,81 për qind e burrave ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen”; tek gratë kjo përqindje ishte 65,15%. Të intervistuarit me

nivele më të larta arsimore kishin më shumë gjasa të mos ishin dakord, ose të mos ishin aspak dakord, me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen.” 34,88 për qind e personave të intervistuar me arsim universitar e lart nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen.” Ndër personat me nivele më të ulëta arsimore kjo përqindje qëndronte tek 13,5%. Krahasuar me të intervistuarit e pamartuar, ata të martuar kishin më pak gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen” (shih Tabelën 66). Sa më i lartë të ishte niveli i të ardhurave familjare, aq më i ulët bëhej niveli i pajtimit me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen.” Familjet në gjendje më të mirë ekonomike ishin më pak dakord me këto role tradicionale. Sa më e madhe mosha, aq më shumë

Figura 22: “Është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen”

● Nuk jam aspak dakord ● Nuk jam dakord ● As 'jam dakord' as 'nuk jam dakord'
● Jam dakord ● Jam shumë dakord





Figura 23: “Një bashkëshorte e mirë duhet t'i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje”

● Nuk jam aspak dakord ● Nuk jam dakord ● As 'jam dakord' as 'nuk jam dakord'
● Jam dakord ● Jam shumë dakord





rritej niveli i pajtimit me pohimin “është më mirë për të gjithë familjen që burri të ketë një punë dhe gruaja të kujdeset për familjen” (shih Tabelën 67).

“Një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje”

Shtatëdhjetë e pesë për qind e personave të intervistuar (n = 338) ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje” (shih Figurën 23).

Të intervistuarit në zonat rurale kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje.” Më konkretisht, 81 për qind e personave të intervistuar në zonat rurale ishin dakord ose shumë dakord me këtë pohim; ndërkohë, 70,4 për qind e personave të intervistuar në zonat urbane ishin dakord ose shumë

dakord me të. Krahasuar me gratë, burrat kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje”: 78,95 për qind kundrejt 71,17 për qind. U vunë re dallime edhe sipas niveleve arsimore. Të intervistuarit me nivel më të lartë arsimor kishin më pak gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje.” Aty ku partnerët/bashkëshortët kishin nivel më të lartë arsimor, personat e intervistuar kishin më pak gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje” (shih Tabelën 68). Sa më i lartë niveli i të ardhurave familjare, aq më i ulët ishte niveli i pajtimit me pohimin “një bashkëshorte e mirë duhet t’i bindet burrit për të ruajtur harmoninë dhe mirëqenien në familje.” I njëjti përfundim ishte i vërtetë edhe për shpenzimet familjare. Sa më e madhe mosha, aq



më i lartë ishte niveli i pajtimit me këtë pohim (shih Tabelën 69).

Vendimi për numrin e fëmijëve

Më se 90 për qind e personave të intervistuar raportuan se vendimi për numrin e fëmijëve duhet të merret si nga burrat ashtu edhe nga gratë (shih Figurën 24).

Gjinia e fëmijës

Përafërsisht 43 për qind e personave të intervistuar thanë se për ta nuk kishte rëndësi se cilës gjini i përkiste fëmija (shih Figurën 25).

Të intervistuarit në zonat urbane kishin më shumë gjasa të raportnin se gjinia e fëmijës nuk kishte rëndësi, kurse ata në zonat rurale kishin më shumë gjasa të raportnin që parapëlqenin një djalë. Dallimi ndërmjet zonave urbane dhe rurale ishte statistikisht domethënës. Më konkretisht, 40,72 për qind e personave të intervistuar në zonat rurale thanë se parapëlqenin djalë, krahasuar me 28,92 për qind të personave të intervistuar në zonat urbane që thanë se parapëlqenin djalë.

Punësimi

Niveli i të qenit i/e kënaqur me pagën

Më se 50 për qind e të intervistuarve në marrëdhënie pune thanë se paga që merrnin nuk i përgjigjej kualifikimeve që kishin. Nuk kishte dallime grave dhe burrave (shih Tabelën 15).

Arsyet e papunësisë

Pak më shumë se 55,33 për qind e pjesëmarrësve në studim (n = 249) raportuan se ishin të papunë. Më se 50 për qind e të intervistuarve të papunë (n = 123) thanë se nuk ishin në gjendje të gjenin punë. Vetëm një numër i vogël i të intervistuarve, 1,33 për qind ose 3 individë, thanë se bashkëshorti/partneri nuk donte që ato të punonin (shih Tabelën 18).

Të ardhurat dhe shpenzimet

Vlera mesatare e të ardhurave personale ishte 20 000 lekë në muaj ($DS = 354\ 702,7$; *intervali*: 20 000- 3 500 000). Burrat kishin të ardhura më të larta ($M = 387\ 794,6$; $DS = 433\ 943$) se sa gratë ($M = 231\ 729,7$; $DS = 132\ 844$). Diferenca ndërmjet dy grupeve – grave dhe burrave - prej 156 064,9 lekë, ishte statistikisht domethënëse. Hendeku i pagave ndërmjet grave dhe burrave ishte më i madh ndër të intervistuarit me nivele me të ulëta arsimore. Dallimi ndërmjet pagave të grave dhe burrave me arsim të mesëm e poshtë ishte 194 053,7 lekë. Vlera mesatare e të ardhurave të burrave me arsim të mesëm e poshtë ishte 391 831,5 lekë ($DS = 474\ 726,8$), kurse vlera mesatare e të ardhurave të grave me arsim të mesëm e poshtë ishte 197 777,8 lekë ($DS = 108\ 409$). Hendeku i pagave ndërmjet grave dhe burrave me arsim universitar e lart është 48 773,91 lekë. Të ardhurat mesatare mujore

familjare ishin 443 698,7 lekë ($DS = 420\,201,7$; intervali: 10 000-4 000 000). Vlera mesatare e shpenzimeve mujore ishte 341 129,7 lekë ($DS = 277\,620,2$; intervali: 10 000- 3 000 000).

Sasia e parave që mbani me vete kur dilni nga shtëpia

Burrat kishin më shumë gjasa se gratë të raportonin që bashkëshortja/partnerja e tyre mbante më pak para në kuletë. Burrat raportuan se gratë mbanin me vete mesatarisht 11 779,08 lekë ($DS = 12\,879,18$; ndërsa gratë raportuan se burrat mbanin me vete mesatarisht 39 017,01 lekë ($DS = 65\,661,24$). Diferenca ndërmjet dy shumave është 27 237,92 lekë.

Pronësia mbi tokën dhe kultivimi i saj

47, 33 për qind e personave të intervistuar ($n = 213$) kishin në pronësi tokë bujqësore. Vlera mesatare e sipërfaqes së tokës ishte 5,57 dynym² ($DS = 5,97$; intervali: 0,15-50). Më se 70 për qind e pjesëmarrësve në studim që kishin tokë ($n = 153$) thanë se e kultivonin atë. Përafërsisht 55 për qind e personave të intervistuar që kishin tokë raportuan se përgjegjësia për kultivimin e tokës ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 21).

Pronësia dhe kujdesi për bagëtitë

24,04 për qind e personave të intervistuar ($n = 107$) raportuan se mbanin lopë dhe 13,06 për qind ($n = 58$) raportuan se mbanin dele dhe/ose dhi. 51,72 për qind e personave të intervistuar që mbanin bagëti raportuan se përgjegjësia e "kujdesit për bagëtinë" ndahet pothuaj barabar ndërmjet grave dhe burrave (shih Tabelën 22).

2. Një dynym është i barabartë me 1 000 m² ose 0,1 ha.

Menaxhimi i parave

Kush i mban paratë në familje

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar, 34,89 për qind ($n = 157$), thanë se paratë në familje i mbante kryefamiljari, ndjekur nga "të gjithë së bashku", me 31,11 për qind ($n = 140$) (shih Tabelën 23).

Përgjegjësia për menaxhimin e parave

Pothuaj gjysma e personave të intervistuar raportuan se "ne i vëmë të gjitha paratë bashkë dhe secili prej nesh merr aq sa i duhet," ndjekur nga "të gjitha paratë i menaxhoj unë" (22,69 për qind) dhe "bashkëshorti/partneri i menaxhon të gjitha paratë" (21,01 për qind) (shih Tabelën 24).

Balanca karrierë – familje

Përgjegjësitë familjare janë pengesë për përparimin në karrierë

Më se 20 për qind e personave të intervistuar (n = 77) raportuan se përgjegjësitë familjare përbënin pengesë për përparimin e tyre në karrierë (shih Figurën 26).

Anëtarët e familjes mbështesin përparimin në karrierë

Më se 90 për qind e personave të intervistuar (n = 298) thanë se anëtarët e familjes e mbështesnin përparimin e tyre në karrierë (shih Figurën 27).

Bashkëshorti/partneri e mbështet përparimin në karrierë

Po kështu, më se 90 për qind e personave të intervistuar që ishin të martuar (n = 248) raportuan se bashkëshorti/partneri e mbështeste përparimin e tyre në karrierë (shih Figurën 28).

“Është mirë nëse gruaja punon, por, mbi të gjitha, ajo duhet të mendojë për familjen dhe fëmijët e saj”

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “është mirë nëse gruaja punon, por mbi të gjitha, ajo duhet të mendojë për familjen dhe fëmijët e saj.” Më konkretisht, 87,34 për qind e personave të intervistuar (n = 393) ishin dakord ose shumë dakord me këtë pohim (shih Figurën 29). Nuk kishte dallime sipas llojit të rajonit, gjinisë, gjendjes civile dhe arsimit (shih Tabelën 70).

“Burri duhet të sakrifikojë karrierën për familjen”

71,11 për qind e personave të intervistuar (n = 320) ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “burri

Figura 26: Përgjegjësitë familjare pengojnë përparimin në karrierë




Figura 27: Anëtarët e familjes mbështesin përparimin në karrierë





Figura 28: Bashkëshorti/partneri e mbështet përparimin në karrierë



duhet të sakrifikojë karrierën për familjen” (shih Figurën 30). Të intervistuarit me nivele me të ulëta arsimore kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “burri duhet të sakrifikojë karrierën për familjen” (shih Tabelën 72).

Sa më e madhe mosha, aq më i madh niveli i pajtimit me pohimin “burri duhet të sakrifikojë karrierën për familjen” (shih Tabelën 73).

“Gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen”



81,11 për qind e personave të intervistuar (n = 365) ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen” (shih Figurën 31).

Personat e intervistuar kishin më tepër gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen”, krahasuar me pohimin “burri duhet të sakrifikojë karrierën për familjen.” Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të

mos ishin dakord, ose të mos ishin aspak dakord, me pohimin “gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen.” Gratë e martuara, krahasuar me ato të pamartuara, kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen.” Të intervistuarit me nivele me të ulëta arsimore kishin më shumë gjasa të ishin dakord ose shumë dakord me pohimin “gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen” (shih Tabelën 74).

Nëse gruaja fiton më shumë të ardhura se burri, kjo krijon probleme në familje

72,16 për qind e pjesëmarrësve në studim (n = 324) nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me pohimin “nëse gruaja fiton më shumë të ardhura se burri, kjo krijon probleme në familje” (shih Figurën 32). Nuk kishte dallime sipas llojit të rajonit, gjinisë, gjendjes civile, dhe arsimit (shih Tabelën 76).



Mundësitë për punësim

40,89 për qind e personave të intervistuar (n = 184) raportuan gratë dhe burrat kishin mundësi të barabarta në tregun e punës, pra, nëse një grua dhe një burrë me të njëjtin nivel arsimor do të aplikonin për të njëjtin vend pune, atëherë mundësitë e tyre për ta fituar atë vend pune ishin të barabarta. 35,33 për qind e personave të intervistuar (n = 159) thanë se “nëse një grua dhe një burrë kanë të njëjtin nivel arsimor dhe aplikojnë për të njëjtin vend pune, burri kishte më shumë gjasa ta marrë atë vend pune.” Ndërkohë 23,78 për qind (n = 107) thanë se gjasat ishin më të mëdha që atë vend pune ta merrte gruaja (shih Figurën 33). Nuk kishte ndonjë dallim (statistikor) sipas gjinisë së të intervistuarit.

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar që thanë se burrat kanë më shumë gjasa ta fitonin vendin e punës, fokusoheshin tek ndarja e punëve të shtëpisë dhe kujdesit për fëmijët. Ata argumentonin se gratë kishin më shumë gjasa se burrat të shpenzonin kohë me rritjen e fëmijëve dhe me punët e shtëpisë. Sipas

tyre, kjo kishte dy pasoja. Së pari, gratë kanë më pak kohë të bëjnë punë të paguar; sepse familja vjen e para. Së dyti, me kalimin e kohës gratë bëhen më pak konkurruese në tregun e punës sepse priren më tepër të mbështesin familjen, se sa të kërkojnë mundësi trajnimi dhe formimi për veten e tyre. Më poshtë po japim disa nga përgjigjet e dhëna: “Gratë janë të zëna me punët e shtëpisë”; “Gratë kanë përgjegjësi familjare”; “Burrat kanë më tepër kohë të lirë; ata kanë më pak angazhime familjare”; “Gratë duhet të rrisin fëmijët dhe të bëjnë punët e shtëpisë”; “Gruaja ka më shumë përgjegjësi për fëmijët në familje”; “Gratë nuk janë mësuar të punojnë jashtë shtëpisë;” dhe “Gratë nuk kanë kohë se kanë punët e shtëpisë.”

Të tjerë përmendnin disa karakteristika, që ata i quanin “cilësi të lindura” të burrave. Ndër komentet e bëra ishin, për shembull, “Burrat janë më të fortë”, “Burrat janë më të aftë”, “Burrat janë më të përgjegjshëm”, “Burrat kanë më shumë të dhëna për role drejtuese”, “Burrat kanë më shumë autoritet dhe janë superiorë. Ata e njohin mirë situatën. Ata kanë lindur për të

Figura 31: “Gruaja duhet të sakrifikojë karrierën për familjen”

● Nuk jam aspak dakord ● Nuk jam dakord ● As 'jam dakord' as 'nuk jam dakord'
● Jam dakord ● Jam shumë dakord




Figura 32: “Nëse gruaja fiton më shumë të ardhura se burri, kjo krijon probleme në familje”

● Nuk jam aspak dakord ● Nuk jam dakord ● As 'jam dakord' as 'nuk jam dakord'
● Jam dakord ● Jam shumë dakord





Figura 33: Mundësitë për punësim

■ Gruaja ■ Burri ■ Mundësi të barabarta




qenë superiorë”, “Burrat kanë më shumë besim në vetvete”, “Në 99 për qind të rasteve dominojnë burrat. Kështu është, dhe gjithmonë kështu ka qenë”. Duke bërë krahasim ndërmjet burrave dhe grave, një nga të intervistuarit tha: “Burrat janë më të fortë dhe janë më në kontroll; gratë janë më të buta dhe më të përkushtuara për familjen.”

Pjesa më e madhe e personave të intervistuar që thanë se gratë kishin më shumë gjasa ta fitonin vendin e punës përmendnin “cilësitë e grave,” sidomos shkathhtësinë, shpirtin krijues, zellin, saktësinë, aftësinë dhe fleksibilitetin e tyre. Të tjerë theksonin se, krahasuar me burrat, gratë kishin aftësi më të mira komunikuese dhe menaxhuese, ishin më të mirë-arsimuara, si dhe më pak të korruptuara. Disa nga të intervistuarit përmendën se gratë duhet të përkrahen në tregun e punës. Një nga arsyet pse gratë mund të mos arrijnë të gjejnë një punë është se ato kanë rrjete shumë të vogla sociale. Kurse burrat kanë më shumë lidhje dhe njohje, ndaj edhe kanë më shumë gjasa të gjejnë mundësi punësimi.

Figura 34: Parapëlqimi për gjininë e drejtuesit

■ Grua ■ Burrë ■ Grua ose Burrë



Parapëlqimi për gjininë e drejtuesit

Më pak se 50 për qind e personave të intervistuar thanë se do të parapëlqenin qoftë një burrë apo një grua si drejtues të tyre në punë (shih Figurën 34).

Gratë kishin më shumë gjasa se burrat të parapëlqenin të kishin për drejtuese një grua. 32,43 për qind e grave (n = 72) thanë se parapëlqenin të kishin për drejtuese një grua, krahasuar me 22,37 për qind të burrave (n = 51) që thanë se parapëlqenin të kishin për drejtuese një grua.

Të intervistuarit raportuan se parapëlqenin të kishin një burrë për drejtues, për shkak të “cilësive që kanë burrat”. Në veçanti ata përmendën se burrat kanë më pak frikë, janë më të vendosur, të kuptueshëm, tolerantë, të përpiktë, të arsyeshëm dhe të drejtë. Një nga të intervistuarit tha se “Burrat dinë t’i menaxhojnë mirë situatat e vështira; atyre u zë fjala vend.”

Burrat raportuan se do të ndiheshin më mirë po të komunikonin me një burrë se sa me një grua. Disa nga

përgjigjet ishin: "Ndiheh më mirë kur komunikon me ta", "burrat e kuptojnë mirë njëri tjetrin; me gratë është e vështirë të merresh vesh." Përveç kësaj, disa nga të intervistuarit ishin kundër idesë së "marrjes së urdhrave nga gratë", apo "të kritikoheshin nga gratë". Një nga të intervistuarit tha "Nuk durohet të të ofendojë një grua."

Personat e intervistuar, që u shprehën se parapëlqenin të kishin një grua për drejtuese, theksuan cilësitë e mëposhtme: aftësitë e tyre komunikuese dhe menaxhuese, tolerancën, dhe mirësjelljen. Disa nga komentet e tyre ishin: "gratë janë më të afta"; "Gratë japin më shumë hollësi; ato i shpjegojnë gjërat"; "Gratë janë më tolerante dhe më të përgjegjshme"; "Gratë janë më të afërta me familjen"; dhe "Gratë punojnë më shumë dhe janë më të përgjegjshme se burrat."

Disa nga gratë e intervistuar thanë se ndiheshin më të lidhura me një grua për shkak të identitetit të përbashkët gjinor. Disa prej përgjigjeve të tyre ishin: "me gratë mund të komunikosh; gratë i kuptojnë problemet e grave të tjera"; "gratë i kuptojnë problemet që ke"; "ti i shpreh ato që ndjen dhe ato të kuptojnë më mirë"; "është më e lehtë për gratë të merren vesh mirë me një grua se sa me një burrë"; "gratë duan gratë"; "një grua do të më lejonte të merrja pushim dhe do të ishte më e lehtë të komunikoj me të"; "ndihem më mirë me një grua; me burrat nuk mund të diskutosh probleme"; dhe "gratë e kuptojnë mirë njëra tjetrën; janë disa gjëra që gratë i dinë ndërsa burrat jo."

Disa nga gratë e intervistuar thanë se ato i shmangeshin kërkimit të një vendi pune aty ku drejtuesi ishte burrë, sepse kjo mund të shkaktonte konflikte në familje. Për shembull, një nga të intervistuarat tha "burri im do të bëhej xheloz." Në mënyrë të ngjashme, një grua tjetër tha: "burri nuk do të më linte [të punoja] po të ishte bosi burrë."

Fushat e ndërhyrjes

Të intervistuarit u pyetën nëse duhet të rriten pjesëmarrja e grave dhe vajzave në tregun e punës dhe kontributi i burrave dhe djemve brenda familjes. Në vijim, atyre iu kërkua të zgjidhnin një prej ndërhyrjeve të dhëna në një listë. Përveç kësaj, ato u nxitën të jepnin edhe sugjerimet e tyre.

Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës

98 për qind e personave të intervistuar (n = 440) thanë se pjesëmarrja e grave dhe vajzave në tregun e punës duhet të rritet.

Mënyrat për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në tregun e punës:

- Shtimi i mundësive për trajnime dhe kualifikim: 71,36 për qind (n = 314);
- Krijimi i mundësive të përkujdesit për fëmijët në komunitet, si kopshte dhe çerdhe: 44,55 për qind (n = 196);
- Nxitja e punësimit të grave në institucionet e nivelit vendor dhe qendror: 58,18 për qind (n = 256);
- Rritja e ndihmesës së burrave në shtëpi: 34,55 për qind (n = 152);
- Krijimi i shtysave për gratë për të hapur bizneset e tyre: 30,91 për qind (n = 136);
- Krijimi i mundësive që gratë të punojnë nga shtëpia: 24,32 për qind (n = 107);

- Sugjerime të tjera: Rregullimi i marrëdhënieve punëdhënës-punëmarrës; puna me anëtarët e familjes që nuk i lejojnë gratë të punojnë; mbështetje më e madhe nga shteti për gratë; ndryshimi i qëndrimeve të shoqërisë ndaj rolit të grave në shoqëri; dhe mbështetje më e madhe nga familja për përparimin e grave në karrierë.

Mënyrat për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në tregun e punës

86,64 për qind e personave të intervistuar (n = 389) thanë se ndihmesa e djemve dhe burrave në shtëpi duhet të rritet. Të intervistuarit kishin më shumë gjasa të ishin dakord me rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës se sa me rritjen e ndihmesës së djemve dhe burrave në shtëpi.

Mënyrat për të rritur pjesëmarrjen e djemve dhe burrave brenda familjes:

- Përfshirja e burrave dhe djemve në punët e shtëpisë: 60,67 për qind (n = 236);
- Nxitja e burrave që të marrin përsipër përgjegjësi për rritjen e fëmijëve: 67,61 për qind (n = 263);
- Mbështetja e burrave për marrjen e lejes së atësisë: 24,94 për qind (n = 97);
- Sugjerime të tjera: Edukimi i djemve me qëndrime barazimtare që në moshë të vogël.

Përfundime dhe diskutime

Ky studim hulumton perceptimet dhe qëndrimet e publikut ndaj barazisë gjinore në Shqipëri. Studimi mori në shqyrtim perceptimet publike në lidhje me aspektet e mëposhtme: ndarja e punëve të shtëpisë; ndarja e përgjegjësiave për rritjen e fëmijëve, perceptimet dhe qëndrimet ndaj rolit të grave dhe burrave në familje, punësimi dhe të ardhurat, menaxhimi i parave, balanca karrierë-familje, fushat e ndërhyrjes për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në tregun e punës, dhe ndihmesa e djemve dhe burrave në familje.

Studimi konstatoi se ekziston një mbështetje e madhe për modelin “burri si fitues i jetesës dhe gruaja si shtëpiake”. Pjesa më e madhe e personave të intervistuar raportuan se janë zakonisht gratë ato që lajnë dhe hekurosin rrobat, pastrojnë shtëpinë, gatujnë, dhe lajnë enët. Dy punët e shtëpisë, ku burrat kishin më shumë gjasa të përfshiheshin se sa gratë, lidheshin me riparimet mirëmbajtëse në shtëpi dhe pagimin e faturave. Gratë dhe burrat kishin më shumë gjasa të ndanin së bashku detyrat e mëposhtme në familje: hedhjen e mbeturinave, bërjen e pazareve, dhe kujdesin për të sëmurët në familje. Gratë bëjnë pjesën më të madhe të rritjes së fëmijëve dhe të punëve të shtëpisë. Ndërsa burrat kishin më shumë gjasa të përfshiheshin në raste të emergjencave shëndetësore, për shembull, për ta çuar fëmijën tek mjeku.

Niveli në të cilin ishin të kënaqura gratë me ndarjen e punëve të shtëpisë nuk ishte shumë i ulët, madje as në rastet kur ato kishin përgjegjësi të plotë për punët e shtëpisë. Një nga shpjegimet për këtë konstatim

është se gratë kanë qëndrime tradicionale për sa i përket roleve në familje. Ndarja e detyrave në familje i përgjigjet pritshmërive të tyre. Pavarësisht nga kjo, niveli i të qenit i/e kënaqur me ndarjen e detyrave në familje ishte më e ulët tek gratë se sa tek burrat.

